



PJESA 4 E LICENCËS SË KPM-së – HARTA E ZONËS SË LICENCUAR

Emri i stacionit:

Indeksi i Medias:

I licencuari:

Data:

1.0 Përkufizime:

- 1.1** Harta e Zonës së Licencuar (HZL) përcaktohet si një ose më shumë harta topografike të përgatitura nga KPM-ja për të shënuar kufijtë fizikë në Kosovë të cilat i Licencuari autorizohet t'i mbulojë sipas kushteve dhe termeve teknikë të përshkruara hollësisht në Pjesën 2 të Licencës.
- 1.2** HZL-ja do t'i jepet të licencuarit në formë të shtypur dhe si figurë digjitale.

2.0 Krite bazë të Vijës kufitare në Hartën e Zonës së Licencuar:

- 2.1.** Vija kufitare e HZL-së është një vijë që përcakton kufirin me një sinjal me fuqi prej 48 dB mikrovolt/m² për FM radio dhe 65-70 dB mikrovolt/m² për televizion UHF që shënohet në kufirin e jashtëm të zonës së kuqe të hartave të KPM-së. Kjo vijë kufitare cakton kufirin përtej të cilit nuk duhet të shkaktohen ndërhyrje në zonën e mbulimit të stacioneve fqinjë që operojnë në të njëjtën frekuencë.

3.0 Veprime të të Licencuarit brenda Hartës së Zonës së Licencuar:

- 3.1** I Licencuari mund të kërkojë të përmirësojë mbulimin zonal brenda HZL-së që i është caktuar atij, duke përdorur transmetues shtesë. Megjithatë, çdo transmetues i tillë shtesë kërkon miratim të veçantë të KPM-së para instalimit dhe vënies në funksion të tyre. KPM-ja do të mundohet që kërkesave të tilla tu japë në kohë përgjigje të favorshme, duke siguruar që një ndryshim i tillë të mos ketë pasoja në Hartën e Zonës së Licencuar.

4.0 Ndryshimi i Hartës së Zonës së Licencuar:

- 4.1** I Licencuari nuk mund ta ndryshojë HZL-në e tij pa miratim paraprak me shkrim të KPM-së. KPM-ja do të miratojë ndryshime të tilla vetëm kur konstaton se ky veprim bëhet për interesa publike.

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pjesën 4 të kësaj Licence.

EMRI:

DATA:

NËNSHKRIMI:

I LICENCUARI:

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, Pjesa 4 e kësaj Licence do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.

NËNSHKRIMI:

DATA:

[Miratuar më 25 prill 2005]